

## NË EMËR TË POPULLIT

10 10 2017  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL**, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi dhe zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale sulm seksual nga neni 232 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 2470-2/2014 e datës 12.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit [REDAKTUAR], të dëmtuarës [REDAKTUAR], me datë 21.07.2017 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 01.08.2017 përpiloi me shkrim këtë:

## AKT GJYKIM

**I pandehuri:** [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR], me vendbanim në Fshati [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i martuar, me profesion përpunues i drurit (zdruktur), i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDAKTUAR]

## ËSHTË FAJTOR

Se me datë 25.09.2014, rreth orës 14:00, në Fshatin [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], përkatësisht në shtëpinë e të dëmtuarës [REDAKTUAR] i pandehuri kishte shkuar për të kërkuar një borxh dhe në derën e hyrjes kishte thirrur në emër të dëmtuarës e cila kishte qenë vetë në shtëpi ku e njëjta kishte qëlluar në dhomën e fjetjes dhe posa kishte dal e kishte njohur të pandehurin nga i cili në treg para një kohe kishte blerë një kompletë prej tri tavolinave të vogla në vlerë prej 50 /pesëdhjetë/ euro, dhe menjëherë ishte drejtuar me fjalët a i ke përgatitur parat e borxhit, ku e dëmtuara i kishte thënë se kemi pasur marrëveshje që ti paguaj me datë 20.10.2014, dhe se tani nuk kishte para e ndërkohë i pandehuri veç kishte hyrë në korridor të shtëpisë dhe e kishte kapur për dore dhe kishte filluar që ti thoshte se ajo i pëlqente dhe kishte filluar që ta prekte nëpër pjesë të ndryshme të trupit me qëllime seksuale e pastaj kishte dashur që ta puthte por e dëmtuara e kishte shtyrë dhe ishte larguar dhe kishte kërkuar nga i pandehuri që menjëherë të ia lëshonte shtëpinë sepse do ta thërriste motrën e burrit ose vjehrrin, pos kësaj i pandehuri kishte dalur nga shtëpia dhe një kohë edhe dy herë kishte kaluar dy herë rreth shtëpisë së të dëmtuarës me kamionet, ndërkohë e dëmtuara kishte

lajmëruar policinë, kurse i pandehuri edhe më pas rreth orës 20:14, të njëjtën datë e kishte thirrur në telefon por kur ishte lajmëruar burri i saj ai e kishte ndërprerë.

**me të cilën ka kryer veprën penale sulm seksual nga neni 232 par. 1 të KPRK-së**

Andaj, Gjykata në bazë nenit 232 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49, 51, 64, 65 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPK-së, e

### G J Y K O N

- Dënim me gjobë në lartësi prej 500 /pesëqind/ €uro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.
- E dëmtuara [REDAKTUAR], nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.
- Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50/pesëdhjetë /€, në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurin gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria themelore në Ferizaj, me aktakuzën e evidentuar PP.II.nr.2470-2/2014 e datës 12.05.2016, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale sulm seksual nga neni 232 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 21 Korrik 2017, në të cilën shqyrtim i akuzuari [REDAKTUAR] u deklarua: ndihem fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, si dhe me tutje shton se i vjen keq, ndihet thellë i penduar, i kërkon falje publike të dëmtuarës, shton se është mbajtësi familjes, i premtion gjykatës se më nuk do të kryej vepra të tilla penale, dhe e lus gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

E dëmtuara [REDAKTUAR] në mendimin e saj lidhur me pranimin e fajesisë në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se: këtë çështje penale i lë vendose gjykatës ndërsa kërkesën pasurore-juridike nuk paraqesë. Nga dita kritike nuk kam pas asnjë lloj kontakti si dhe as nje lloj mosmarrëveshje.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor si dhe deklarata e të dëmtuarës e dt.25.09.2015, raporti i policisë 2014-CD-128, deklarata e Radoljub Kerstiq e dt.25.09.2014, pjesërisht deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.02.10.2014, fotografia e cila gjendet në shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

- Me qenë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me fjalën përfundimtare respektivisht shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: se me date dhe kohe të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri kishte shkuar për të kërkuar një borxh dhe në derën e hyrjes kishte thirrur në emër të dëmtuarën e cila kishte qenë vetë në shtëpi ku e njëjta kishte qëlluar në dhomën e fjetjes dhe posa kishte dal e kishte njohur të pandehurin nga i cili në treg para një kohe kishte blerë një kompletë prej tri tavolinave të vogla në vlerë prej 50 /pesëdhjetë/ euro, dhe menjëherë ishte drejtuar me fjalët a i ke përgatitur parat e borxhit, ku e dëmtuara i kishte thënë se kemi pasur marrëveshje që ti paguaj me datë 20.10.2014, dhe se tani nuk kishte para e ndërkohë i pandehuri veç kishte hyrë në korridor të shtëpisë dhe e kishte kapur për dore dhe kishte filluar që ti thoshte se ajo i pëlqente dhe kishte filluar që ta prekte nëpër pjesë të ndryshme të trupit me qëllime seksuale e pastaj kishte dashur që ta puthte por e dëmtuara e kishte shtyrë dhe ishte larguar dhe kishte kërkuar nga i pandehuri që menjëherë të ia lëshonte shtëpinë sepse do ta thërriste motrën e burrit ose vjehrrin.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale sulm seksual nga neni 232 par. 1 të KPRK-së, për të pandehurin [REDAKTUAR] të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori

parasysh pranimit e fajësisë, si rrethan lehtësuese pendimi e sinqert dhe real, kërkim faljen publike, mbajtës i familjes, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin si në si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimit e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

E dëmtuara [REDAKTUAR] nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.


Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50/pesëdhjetë /€, në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr. 374/16 datë 01.08.2017.**

Zyrtare ligjore

Kadishe Shabani



Gjyqtari: Ilir BYTYQI



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.